

**Fitim RIFATI**

**VEÇORI TË PUSHTIMIT DHE ADMINISTRIMIT AUSTRO-HUNGAREZ NË PEJË (1915-1918)**

Kërkimi shkencor historiografik për qendrat e Kosovës gjatë Luftës së Parë Botërore është i kënaqshëm dhe akoma përbën një segment hulumtimi të rëndësishëm e të domosdoshëm. Në këtë, kontekst, pushtimi dhe administrimi austro-hungarez i Pejës dhe rrethinës nga 7 dhjetori i vitit 1915 deri më 12 tetor të vitit 1918, pothuajse një periudhë tre-vjeçare, u shoqëruara me zhvillime të rëndësishme politike, ushtarake, ekonomike, shoqërore e kulturore-arsimore, në suaza të Luftës së Parë Botërore. Kjo trevë e Kosovës kishte rëndësi strategjike për Austro-Hungarinë dhe kishte rëndësi specifike për shqiptarët, për aspiratat politike dhe për zhvillimin shoqëror e kulturor të tyre. Këto vite u karakterizuan me ngjarje dhe fenomene shumëdimensionale, që nisën me një përballje të armatosur shqiptaro-malazeze dhe përfunduan njësoj me një përballje të armatosur shqiptaro-austro-hungareze.

Lufta e Parë Botërore e gjeti Pejën nën pushtimin dhe administrimin e rëndë të Mbretërisë së Malit të Zi. Fillimi i saj pezulloi një fushatë intensive malazeze në detyrim të shqiptarëve për t'u shpërngulur nga vatrat e tyre, për tjetërsimin kulturor dhe kombëtar të shqiptarëve që vazhdonin të qëndronin në vatrat e tyre dhe për kolonizimin malazez të kësaj treve. Ndërkohë, Lëvizja Kombëtare Shqiptare, në gjirin e së cilës ishin aktivë edhe veprimtarë nga Peja, konsideroi se përplasja ushtarake midis Austro-Hungarisë dhe aleatëve të saj në njërin anë, kundër Mbretërisë së Serbisë dhe Malit të Zi në anën tjetër, ishte një moment strategjik për të riaktivizuar përpjekjet e armatosura për çlirim. Për këtë qëllim, Lëvizja Kombëtare Shqiptare e ngarkoi veprimtarin e shquar të saj, Qerim Begolli nga Peja, të komandonte vazhdimin e aksioneve të

armatosura kundër pushtetit shtypës serbo-malazez në Kosovë.<sup>1</sup> Nën ndikimin e tij, një varg pejanësh u bënë përkrahës të vazhdueshëm të kësaj ideje. Mirëpo, autoritetet ushtarake malazeze në Pejë e rrethinë reagues menjëherë, duke shtuar kontrollet ndaj popullsisë e vijës kufitare me Shqipërinë dhe bllokuan të gjitha korridoret rrugore që vlerësoheshin të rrezikshme. Në shërbim të këtyre masave u ngritën pengesa telash përreth rrugëve.<sup>2</sup> Rrjedhimisht, për një periudhë më tepër se një-vjeçare, sulmet e armatosura dhe sporadike nga shqiptarët e këtyre trevave nuk arritën efektin që synonin.

Në fund të vitit 1915, Peja dhe rrethina e saj u bënë arenë betejash ndërmjet forcave ndërluftuese të Bllokut Qendror dhe atij të Antantës. Gradualisht, pas pushtimit të një varg qytetesh kryesore gjatë muajve tetor-nëntor 1915, ushtria austro-hungareze dhe aleatët e saj detyruan tërheqjen serbo-malazeze nga Kosova. Mirëpo, i vetmi qytet ku forcat ushtarake të Fuqive Qendrore nuk kishin arritur ende ta pushtonin, ishte Peja. Aty u përqendrua një numër i madh forcash ushtarake serbo-malazeze, që kishin planifikuar të rezistonin. Pas qëndresës disaditore ndaj ushtrisë austro-hungareze e grupeve të armatosura shqiptare, forcat ushtarake serbo-malazeze përshpejtuan largimin nga Peja. Rrjedhimisht, në zonën kufitare në veri të Beranës, trupat austro-hungarezë të ardhur nga Mitrovica kishin sulmuar pozicionet kryesore të ushtrisë malazeze. Më 6 dhjetor 1915, ato zhvilluan luftime të ashpra në lindje të Pejës, mirëpo trupat malazezë e serbë nuk mundën t'i rezistonin sulmit austro-hungarez. Atë ditë trupat austro-hungarezë qëndruan afër qytetit të Pejës. Në mëngjesin e 7 dhjetorit 1915, ato u futën në Pejë.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë (AIHT), Fondi: Arkivi i Vjenës, Vj. 24-36-3634, nr. 403, Telegram i Ambasadës austro-hungareze në Durrës dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Durrës, 6 shtator 1914.

<sup>2</sup> Po aty, Vj. 24-36-3626, nr. 429, Telegram i konsullit austro-hungarez në Shkodër, Halla, dërguar MPJ në Vjenë, Shkodër, 30 gusht 1914.

<sup>3</sup> Der österreichisch-ungarische Heeresbericht: Ipek und Djakova in Montenegro besetzt, Der Stellvertreter des Chefs des Generalstabes. v. Hoefler, Feldmarschalleutnant, Wien, 7. Dezember 1915, *Amtliche Kriegs-Depeschen nach Berichten des Wolff'schen Telegr.-Bureaus*, Band 3, Berlin: "Nationaler Verlag", 1916; *Reichspost*, "Unsere Truppen vor Ipek. 2100 Serben und Montenegriner gefangen.", nr.574, XXII. Jahrgang, Wien, Dienstag den 7. Dezember 1915, seite 2; *L'Home Enchainé*, "Les opérations contre le Monténégro", No.424, Paris, Mercredi, 8 decembre 1915, f.1; *Streffleur Katonai lapja*, "A balkáni hadműveletek.", nr.57, Bécs, szombat, 11. december 1915, oldal 5-6; *Vëllazënia*, "Lufta Balkane. Kalendari i luftës prej fillësës së mësymes së re të fuqivet qendrave.", nr.1, Vjenë, 12 Kallënduer 1916, f.2-3.

Në luftën për të mbrojtur Pejën nga sulmet ushtarake të artillerisë austro-hungareze dhe grupeve të armatosura shqiptare, ushtria serbo-malazeze kishte bërë qëndresë dyditore. Gjatë pushtimit të Pejës u zunë më shumë se 1 000 robër serbë dhe sasi e madhe e materialit të luftës.<sup>4</sup> Midis të zënëve robër ishin edhe dy oficerë serbë.<sup>5</sup> Në luftën për Pejën u përfshinë aktivisht edhe shqiptarët, raportonte gjenerali austro-hungarez, Hofer.<sup>6</sup> Më 6 dhjetor 1915, në Pejë të parët hynë shqiptarët në krye me Bajram Currin e Qerim Begollin.<sup>7</sup> Pas tyre, si triumfuese hyri edhe ushtria austro-hungareze, e cila menjëherë mori situatën nën kontroll.

Pushtimi austro-hungarez i Pejës bëri jehonë edhe në shtypin ndërkombëtar. Gazeta australiane *The Mercury*, duke u mbështetur në burimet evropiane të informimit, më 10 dhjetor 1915, në artikullin me titull “Battle of Ipek” (“Beteja e Pejës”), shkruante se, të martën e 7 dhjetorit 1915, afër Pejës, ushtria austro-hungareze kishte zënë robër 2 000 ushtarë dhe kishte kapur 80 armë.<sup>8</sup> Forcat austro-hungareze dhe aleatët e tyre gjermanë përdorën edhe avionët ushtarakë për të luftuar caqet e ushtrisë serbo-malazeze në tërheqje drejt Podgoricës. Veç kësaj, numri i të zënëve robër rritej vazhdimisht, ndërsa zbulimi dhe konfiskimi i armëve paralizonte idetë eventuale për rezistencë. Ditët vijuese, pas pushtimit të Pejës, u arrestuan mbi 1 000 serbo-malazezë dhe u zbuluan 122 armë moderne të fshehura.<sup>9</sup> Pas disa ditësh, shtypi ndërkombëtar, duke

<sup>4</sup> Dielli, “Shqiptaret marrin piese ne luften per Ipekun”, nr. 534, Boston, Mass., December 8, 1915, f. 1; *Le Petit Journal*, “Les Autrichiens tenus en échec par les Monténégrins”, No.19339, Paris, Mercredi, 8 decembre 1915, f.3; *La Lanterne*, “Comuniqué monténégrin”, No.14.018, Paris, Venredi, 10 decembre 1915, f.1; Peter Enne, *Die österreichisch-ungarische Offensive gegen Montenegro 1916 unter besonderer Berücksichtigung der Operation über den Lovćen und des Zusammenbruchs der montenegrinischen Armee*, Diplomarbeit, Wien: Universität Wien, 2008, f.53.

<sup>5</sup> *Arbeiter-Zeitung*, “Südöstlicher Kriegsschauplatz.”, nr.340, XXVII. Jahrgang., Wien, Freitag, 10. Dezember 1915, seite 1.

<sup>6</sup> *Streffleur Katonai lapja*, “A balkáni hadműveletek.”, nr.57, Bécs, szombat, 11. december 1915, oldal 6.

<sup>7</sup> Dielli, “Shqiptaret”, nr. 568, Boston, Mass., Wednesday, January 19, 1916, f. 2; N. Ferizi, *Familja Curri*, f. 25.

<sup>8</sup> *The Mercury*, “Battle of Ipek.”, No. 14,274, Hobart, Friday, December 10, 1915, page 5. Varësisht nga autenticiteti i informacioneve dhe shpërndarja e tyre në agjenci informimi, në fillim raportohej për shifra të ndryshme të të zënëve robër. Kështu, në raportime të tjera informative thuhet se gjatë pushtimit të Pejës u zunë robër 1 250 ushtarë. Mirëpo, numri i tyre është rritur dita-ditës. Shih: *The Carolina Home and Farm and The Eastern Reflector*, “Attempt crush Allied troops in Macedonia”, Volume 47, Greenville, North Carolina, Friday, December 10, 1915, page 1.

<sup>9</sup> Der Weltkrieg am 13. Dezember 1915: Balkankriegsschauplatz, *Amtliche Kriegs-*

shpalosur rrjedhat politike të luftës në Ballkan, vlerësoi qëndrimin e mëparshëm të Austro-Hungarisë ndaj shqiptarëve, ku raportonte se ajo “*me sa duket parashikon një protektorat shqiptar, duke përfshirë Pejën dhe Gjakovën*”.<sup>10</sup> Mirëpo, me gjithë pëlqimin e qarqeve politike dhe diplomatike në Vjenë në shërbim të aspiratave kombëtare shqiptare, qarqet ushtarake austro-hungareze që në fillim nuk parapëlqyen ndryshime territoriale dhe administrative në favor të shqiptarëve. Rrjedhimisht, Peja vazhdoi të ruante statusin e qarkut administrativ në kuadër të qeverisë së Përgjithshme Ushtarake austro-hungareze të Malit të Zi me qendër në Cetinë.<sup>11</sup>

Megjithëkëtë, okupatori i ri nuk gjeti mjedis plotësisht të ngrohtë në popullsinë e kësaj treve, për t’i mundësuar me qetësi vendosjen e administratës dhe organeve ekzekutive. *Së pari*, shqiptarëve nuk iu njohën të drejtat politike nga shteti austro-hungarez, ndërsa ushtarakët dhe prijësit e ushtrisë austro-hungareze, veçanërisht ata me kombësi sllave, nuk kishin njohuri solide ndaj kulturës, dokeve, traditës dhe vetëdijes kombëtare të shqiptarëve.<sup>12</sup> *Së dyti*, rendi e qetësia nuk mund të vendoseshin menjëherë për shkak të orientimeve kundërtëse politike të një pjeseje të parisë dhe popullsisë së kësaj treve, e cila gjatë pushtimit dhe administrimit malazez ishte angazhuar me pjesëmarrje aktive në pozicione të administratës së qytetit.<sup>13</sup> Dhe, *së treti*, tensionet e ndërsjella i shtoi edhe një masë shqiptarësh myslimanë, të aftë për luftë dhe akoma me ndjesi për shtetësinë osmane, që iu përgjigj propagandës për të emigruar drejt

---

*Depeschen nach Berichten des Wolff’schen Telegr.-Bureaus*, Band 3, Berlin: "Nationaler Verlag", 1916.

<sup>10</sup> *The Ashburton Guardian*, “Roumania’s policy may result in new war zone.”, Vol. XXXV, No. 8327, Ashburton, New Zeland, Tuesday, December 21, 1915, page 5.

<sup>11</sup> Fitim Rifati, *Kosova gjatë Luftës së Parë Botërore, 1914-1918*, Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 2019, f. 167.

<sup>12</sup> *AIHT*, Vj. 26-7-719, nr. 25,492, Aneks i Kryekomandës së ushtrisë, 20 maj 1916.

<sup>13</sup> *Po aty*, Vj.26-3-393, nr. 867/res, Shtojcë e shkresës private dërguar nga konsulli i përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Kral, për Alfred fon Rappaport, Shkodër, 13 gusht 1916. Sefedin bej Begolli, i cili pas pushtimit malazez ushtroi funksione administrative në sektorin e gjyqësorit në Pejë, në një fjalim të botuar në shtypin malazez, në nëntor 1913, tregonte përkushtimin dhe besnikërinë e tij ndaj Mbretërisë së Malit të Zi, duke vlerësuar goja “tolerancën fetare midis të krishterëve dhe myslimanëve” nën sundimin malazez. Ai shprehte gatishmërinë që të flijojë për interesat e Malit të Zi. Shih më gjerësisht: *Глас Црногорца*, "Говор г. Сафедин бега Махмутбеговића", број 52., Цетинье, субота, 9. новембра 1913., страна 5.

Perandorisë Osmane dhe për t'iu bashkuar ushtrisë së saj në frontin e Galicisë.<sup>14</sup>

Kësisoj, autoritetet austro-hungareze ndaj shqiptarëve të pabindur ndërmoren menjëherë masa ndëshkuese si: burgosje, internime dhe ekzekutime, ndërsa në Kuqishtë vendosën një stacion policor për të mbajtur rugovasit nën kontroll.<sup>15</sup> Ndërkohë, gjatë muajit qershor dhe korrik të vitit 1916, në rrethin e Pejës u shënuan raste kur një pjesë shqiptarësh dhe serbo-malazezësh, në kuadër të përpjekjeve malazeze kundër pushtimit austro-hungarez, realizuan aksione të armatosura ndaj pjesëtarëve të xhandarmërisë austro-hungareze. Në mesin e muajit korrik 1916, në rrethinën e Pejës, përkatësisht në rrugën që çon nga Runiku në drejtim të Mitrovicës, shqiptarët sulmuan dhe vranë 2 xhandarë austro-hungarezë. Në shenjë hakmarrjeje, organet ushtarake austro-hungareze paralajmëruan dhe nuk vonuan me zbatimin e ndëshkimeve ndaj shqiptarëve dhe serbo-malazezëve të këtij rrethi. Për rrjedhojë, më 21 korrik 1916, jo vetëm për të ndëshkuar shqiptarët që kishin kryer sulme të armatosura ndaj tyre, por edhe për të krijuar frikë tek pjesa tjetër e popullsisë, që pretendonte të realizonte aksione kundër pushtetit administrativ, në qytetin e Pejës përmes një procedure të shpejtë gjyqësore u ekzekutuan shtatë shqiptarë me akuzën “*për krimin kundër fuqive të armatosura të shtetit* (ushtrisë së Perandorisë Austro-Hungareze, F. R)”. Veç kësaj, autoritetet ushtarake vranë edhe tre shqiptarë të tjerë në këtë qytet, sepse tentuan të arratiseshin dhe t'i shpëtonin ndëshkimit.<sup>16</sup>

Kjo ngjarje shkaktoi edhe reagimin e shpejtë të shtypit ndërkombëtar, veçanërisht atij të shteteve të Antantës. Më 18 gusht 1916, gazeta britanike *Daily Telegraph*, në bazë të raportuesit të saj nga Roma, publikoi të dhëna mbi vrasjet e fundit të realizuara nga ushtria austro-hungareze në Shqipëri, Serbi dhe Mal të Zi. Sipas saj, vetëm gjatë muajit korrik në këto vende autoritetet ushtarake austro-hungareze kishin ekzekutuar 808 vetë, midis tyre edhe shqiptarë nga Peja. I menjëhershëm ishte kundërveprimi i shtypit austro-hungarez, i cili raportimet e shtypit të Antantës i kualifikoi si gënjeshtër. Në gazetën austro-hungareze, *Arbeiter-*

<sup>14</sup> Hasan Bello, *Marrëdhëniet shqiptaro-turke 1912-1939*, Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike - Instituti i Historisë, 2015, f. 125.

<sup>15</sup> Shukri Rahimi, “E kaluara historike e Rugovës”, *Rugova - Monografi etnografike* - Libri XIV, Sesioni i Shkencave Shoqërore, Libri 6, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 1987, f. 27.

<sup>16</sup> *AIHT*, Vj. 26-1-118, nr. 1861/II, Aneksi i relacionit nr. 58A-B/p, të datës 23 korrik 1916 i ministrit fuqiplotë Eduard Otto, përfaqësues i MPJ në Cetinë dërguar MPJ në Vjenë, Cetinë, 22 korrik 1916.

*Zeitung* dhe *Pester lloyd*, u demantuan pretendimet e shtypit të Antantës për sjelljet e ushtrisë austro-hungareze në Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi. Shtypi austro-hungarez në raportet e tij pranoi se në korrik të vitit 1916, në Pejë u ekzekutuan 9 shqiptarë për krime kundër pushtetit ushtarak. Mirëpo, shtypi austro-hungarez insistonte se në viset shqiptare nën Austro-Hungarinë, ekzistonte qetësi e plotë dhe se pushteti administrativ ishte i pranueshëm për popullsinë vendëse.<sup>17</sup>

Rrjedhimisht, gjatë kësaj kohe, autoritetet austro-hungareze në qarkun e Pejës zbatuan masa të rrepta për individët që mbanin armë pa leje dhe kufizuan lirinë e lëvizjes nga një qark administrativ në tjetrin. Në rast se armët nuk dorëzoheshin me kohë, atëherë pasonte dënimi me vdekje. Kësisoj, vetëm në këtë zonë u ekzekutuan 15 vetë. Veç kësaj, ato morën edhe pengje pjesëtarë të familjeve të shqiptarëve, të cilët ishin të armatosur dhe kërcënonin rendin administrativ. Për çdo vrasje, e cila kualifikohej si vepër penale, vrasësi ishte i obliguar të paguante si kompensim 25 000 korona. Kështu, deri në dhjetor të vitit 1916, në qarkun e Pejës ishin paguar 50 000 korona për dy xhandarë austro-hungarezë të vrarë, dorasit e të cilëve ishin ende të panjohur.<sup>18</sup> Ekzekutimi i shqiptarëve në Pejë u bë në përputhje me ligjin e luftës për krime parimisht të provuara. Ndërsa ligji austro-hungarez i luftës për këtë akt parashihte dënim me vdekje (likuidim fizik).<sup>19</sup>

Veç kësaj, pas trazirave të qershorit dhe korrikut, në kuadër të qarkut të Pejës u internuan rreth 100 shqiptarë të tjerë, midis tyre bejlerë të Pejës e fëmijë të moshave 14 e 18 vjeçe, siç ishin vëllezërit e Qerim Begollit.<sup>20</sup> Ata u internuan në Aschach, Waidhofen e Karlstein të Austrisë dhe në Boldogasszony, Nezsider, Nagymegyeri e Szolnok të Hungarisë. Kësisoj, të internuar nga Peja pati sidomos nga familja e njohur

<sup>17</sup> *Arbeiter-Zeitung*, "Ententelügen über die Verhältnisse in Serbien, Montenegro und Albanien.", nr.238, XXVIII. Jahrgang., Wien, Montag, 28. August 1916, seite 2; *Pester lloyd*, "Ententelügen über die Verhältnisse in Serbien, Montenegro und Albanien.", nr.239, 63. Jahrgang, Budapest, Montag, 28. August 1916, seite 4.

<sup>18</sup> F. Rifati, *Kosova gjatë Luftës...*, f.205.

<sup>19</sup> *AIHT*, Vj. 26-17-1799, nr. 84/P, Raport tepër sekret i përfaqësuesit të MPJ në Cetinë, Otto, dërguar baronit Burian në Vjenë, Cetinë, 8 tetor 1916; Xhevat Repishti, "Revolta e masave të Shkodrës në pranverën e vitit 1916 kundër pushtesve austro-hungarezë", në *Studime historike*, viti XXVII (X), nr. 1, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSH & Instituti i Historisë, 1973, f. 74; Ledia Dushku, "Shqiptarët përballë ushtarakëve dhe diplomatëve austro-hungarezë (1914-1916)", në *Studime historike*, Viti LXX 3-4/2016, Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike - Instituti i Historisë, 2016, f. 82.

<sup>20</sup> *Po aty*, Vj. 26-18-1809, nr. 1135/Res, Aneks i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shodër, Kral, dërguar Alfred von Rappaport, Shkodër, 3 dhjetor 1916.

Mahmutbegolli. Rrjedhimisht, Sefedin bej Begolli u internua në Waidhofen, Esad bej Mahmutbegolli, Abdulla bej Mahmutbegolli, Kemal bej Mahmutbegolli e Munir bej Mahmutbegolli u internuan në Aschach. Abdurrahman Mahmutbegolli e Kemal bej Mahmutbegolli u internuan në Bologasszony. Ragib bej Kajabegolli, Ramiz bej Kajabegolli, Mahmud Zajmi, Bilall Rrusta, Shaqir Çavdërbasha e Ali Goska u internuan në Aschach. Krerë e personalitete të njohura të qarkut të Pejës u internuan edhe në vise të tjera të Austro-Hungarisë.<sup>21</sup> Kësaj maseje ndëshkimore nuk i shpëtuan as klerikët fetarë ortodoksë të qarkut të Pejës.<sup>22</sup>

Hasan Prishtina, i cili në këtë kohë vepronte në zonën e pushtimit dhe administrimit austro-hungarez në Kosovë, në kuadër të masave të internimit konsideronte se më të rrezikshëm, për shkak të elasticitetit politik dhe administrativ që kishin treguar me zgjedhën malazeze, mund të cilësoheshin Sefedin bej Begolli, Mahmut Zajmi, Sulejman Agë Batusha, Muhamed Grezda etj. Ai përpiqej të bindte organet e administratës ushtarake austro-hungareze se internimi i bejlerëve e personaliteteve të tjerë ishte i gabueshëm, sepse ndikonte negativisht në përshtypjet e shqiptarëve të Pejës mbi qëndrimin austro-hungarez ndaj tyre.<sup>23</sup> Në këtë kontekst, reagimi i menjëhershëm i Hasan Prishtinës dhe sugjerimi që ai i bëri autoriteteve përkatëse austro-hungareze, reflektoi në ndryshimin e pikëpamjeve për krerët kryesorë të Pejës. Rrjedhimisht, autoritetet austro-hungareze morën masa për verifikimin e personaliteteve të kësaj treve, të cilët nuk paraqisnin rrezik për rendin dhe sigurinë. Ndërsa kthimi i Qerim Begollit nga arratia në Prishtinë, ndodhi po ashtu me sugjerim dhe ndërmjetësim të Hasan Prishtinës.<sup>24</sup>

Ndërkohë, një problem i rëndësishëm që rriti tensionin e ndërsjellë, kishte të bënte me një masë shqiptarësh myslimanë të aftë për luftë dhe akoma me ndjesi për shtetësinë osmane. Ata emigruan drejt Perandorisë Osmane dhe u bashkëngjitën me ushtrinë e saj në frontin e Galicisë.

<sup>21</sup> Vukota Vukotić, "Muslimani internirani u Austro-Ugarsku 1916-1918", *Almanah*, nr.75-76, Časopis za proučavanje, prezentaciju i zaštitu kulturno-istorijske baštine Bošnjaka/Muslimana, Podgorica: 2017, f. 295-298.

<sup>22</sup> Në janar të vitit 1917, në Mal të Zi u kthye nga internimi një masë klerikësh ortodoksë. Në mesin e tyre ishin edhe Theofan Gjoković, Milutije Vuković e Grigarije Ristić nga Peja. Shih: *Cetinjer Zeitung*, "Rückkehr internierter Geistlicher nach Montenegro.", nr.45, Cetinje, am 18. Jänner 1917, seite 3.

<sup>23</sup> *Po aty*, Vj.26-18-1809, nr. 1135/Res, Aneks i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shodër, Kral, dërguar Alfred von Rappaport, Shkodër, 3 dhjetor 1916.

<sup>24</sup> Limon Rushiti, *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918*, Prishtinë, "Rilindja", 1986, f. 188.

Krahas tyre, një pjesë tjetër u shtrëngua të shërbente në kuadër të administratës ushtarake në zonën austro-hungareze e jashtë saj. Mirëpo, Vjena zyrtare u alarmua jashtëzakonisht nga fakti se rreth 6 000 “vullnetarë shqiptarë myslimanë” prej rretheve të Pejës, Plavës dhe Gucisë, kërkonin të pajiseshin me pasaporta osmane, për të shkuar në Perandorinë Osmane dhe për të luftuar përkrah forcave ushtarake të saj në frontet lindore të luftës.<sup>25</sup> Ky qëndrim i tyre nuk u mirëprit nga organet më të larta politike dhe diplomatike në Vjenë, të cilat kategorikisht kundërshtonin çdo politikë ushtarake që godiste shqiptarësinë e Kosovës.

Pas instalimit të mekanizmave administrativë dhe vendosjes së rendit, nisi zbatimi i politikave ekonomike austro-hungareze në Pejë, të cilat reflektuan në sektorë të caktuar ekonomikë të këtij qyteti dhe viseve përreth. Vlen të theksohet se gjendja ekonomike në Pejë e rrethinë të saj pas pushtimit austro-hungarez vijoi të ishte e rëndë, për shkak të politikës ekonomike malazeze. Nuk munguan raste kur popullsia vuante nga uria. Kësisoj, për të zbutur gjendjen e rëndë me të cilën po përballej popullsia, autoritetet austro-hungareze u kujdesën që me një varg masash të menjëhershme të ndikonin në përmirësimin e kushteve të ushqimit. Ndonëse nuk kishte ushqim me bollëk, nga prilli deri në korrik 1916, autoritetet administrative sollën miell, misër, perime, sheqer dhe ia shpërndanë popullsisë si pjesë e ndihmës ushqimore, madje në raste të veçanta duke zbatuar edhe kanalet e këmbimit.<sup>26</sup> Për këtë arsye, në tetor 1916, shqiptarët e rrethit të Pejës i paraqitën autoriteteve austro-hungareze kënaqësinë me administrimin e qytetit të tyre nga monarkia dualiste, e cila “*po vepronte vetëm për të mirën e vendit*”.<sup>27</sup>

Ndërkaq, Peja e viset përreth kishin rëndësi të madhe për shfrytëzimin ekonomik në bujqësi, tregti e komunikacion rrugor. Rrafshi i Dukagjinit vazhdonte të mbetej hambari kryesor i drithit për Malin e Zi dhe administratën austro-hungareze. Rreth 75% e prodhimit të përgjithshëm të drithit në Mal të Zi vinte nga kjo trevë. Sipas vlerësimeve të guvernatorit të përgjithshëm ushtarak austro-hungarez në Mal të Zi, Klam Martiniq, në dhjetor të vitit 1917, nga 600 vagonë me drithë që u

<sup>25</sup> H. Bello, *Marrëdhëniet shqiptaro-turke...*, f. 125.

<sup>26</sup> *Pester Lloyd*, "Ententelügen über die Verhältnisse in Serbien, Montenegro und Albanien.", nr. 239, 63. Jahrgang, Budapest, Montag, 28. August 1916, seite 4.

<sup>27</sup> *Cetinjer Zeitung*, "Albanische Führer in Albanien.", nr.20, Cetinje, am 22. Oktober 1916, seite 3.

nxorën në Mal të Zi, 450 vagonë vinin nga Peja.<sup>28</sup> Toka pjellore, kushtet klimatike dhe rendimenti i pasur bujqësor, e bënë administratën austro-hungareze me qendër në Cetinë që të përqendronte vëmendjen e saj ekonomike mbi këtë trevë dhe ta trajtonte atë si burimin kryesor për qëndrueshmërinë ekonomike të Malit të Zi.

Nga viti 1917, organet e administratës austro-hungareze të departamentit civil në qarkun e Pejës, bënë edhe regjistrimin e dyqaneve, firmave dhe kompanive tregtare. Vetëm në qytetin e Pejës u regjistruan 369 pronarë dyqanesh, firmash ose kompanish. Prej tyre, 244 (66%) dyqane, firma ose kopani kishin pronarë myslimanë e të krishterë (kryesisht shqiptarë\*), 113 (30%) dyqane, firma ose kompani kishin pronarë të krishterë (kryesisht serbo-malazezë\*), ndërsa 12 (4%) dyqane, firma ose kompani kishin më shumë se një pronar ose kishin pronarë të huaj. Kështu, 5 dyqane kishin pronarë austro-hungarezë, 2 dyqane kishin nga 2 pronarë serbo-malazezë, një dyqan kishte 2 pronarë (një shqiptar dhe një serbo-malazez), 1 dyqan kishte 2 pronarë (një shqiptar dhe një joshqiptar), 1 dyqan u regjistrua pa pronar. Në 10 raste, një pronar kishte dy dyqane; në 9 raste, dy pronarë kishin një dyqan; në 2 raste, dy pronarë kishin dy dyqane.<sup>29</sup> Në pasqyrën e mëposhtme tabelore, del se në qytetin e Pejës kishte 32 lloje dyqanesh që në total arrinin numrin 381. Qyteti dominohej nga dyqane specialiteti dhe mallrash të përgjithshëm.

Numri	Lloji i dyqanit, firmës ose kompanisë	Sasia
1.	Antikitetesh	1
2.	Argjendari	12
3.	Bakri	5
4.	Dërrase	2

<sup>28</sup> *AIHT*, Vj. 27-2-257, pa nr, Shkresë e Guvernatorit të Përgjithshëm ushtarak në Mal të Zi, kontit Klam Martiniq, dërguar ministrit të Jashtëm kontit Czernin në Vjenë, Cetinë, 13 dhjetor 1917.

\* Mund të përmendim disa prej tyre, si: Abdulla Mustafa, Agush Sulejman Zeka, Ali Fetah Kullashi, Avdulla Aligjiku, Beqir Hajdar Aligjiku, Brahim Malë Belegu, Ethem Sapunxhiu, Halim Haxhi Jashari, Haxhi Emin Zajmi, Haxhi Hasan Muhaxheri, Idriz Mula, Isa Halit Blaku, Jakup Radoniqi, Lorenc Gjon Augustini, Mehmed Jahja Kasapi, Mustafa Gega, Rexhep Hajdari, Shaban Belegu, Shyqri Rashiti, Zef Pjetri etj.

\* Mund të përmendim disa prej tyre, si: Aleksija Stefançeviq, Arso Jovanoviq, Cvetko Momiq, Ljubomir Teodosijeviq, Malishiq Stefançeviq, Milan Jovanoviq, Todor Joksimoviq, Zhivko Radevq etj.

<sup>29</sup> Shih më gjerësisht numrat e botuar të *Cetinjer Zeitung* nga data 17 mars deri më 30 qershor 1918.

5.	Duhani	11
6.	Ëmbëltore	5
7.	Floktari	9
8.	Frutash	2
9.	Buke	12
10.	Gëzofi	5
11.	Farkëtari	2
12.	Han	6
13.	Hekurishte	2
14.	Hidrauliku	3
15.	Hotel	1
16.	Kafene	15
17.	Kapaku	1
18.	Këpucësh	9
19.	Letre	1
20.	Lëkure	2
21.	Mallrash të përgjithshëm	67
22.	Manifakture	1
23.	Mishi	1
24.	Ngjyrash	1
25.	Opingash	9
26.	Orëtari	5
27.	Rrobaqepësi	27
28.	Sapuni	2
29.	Specialiteti	143
30.	Shale	8
31.	Taverna	8
32.	Thasësh	3
<b>Gjithsej:</b>		<b>381</b>

**Pasqyrë dyqanesh, firmash dhe kompanish të regjistruara në qytetin e Pejës gjatë vitit 1917-1918.**

Vëmendje e posaçme iu kushtua edhe përmirësimit të kushteve të komunikacionit rrugor, që mundësonte lëvizjen e strukturave administrative austro-hungareze dhe popullsisë nga një qark në tjetrin, nga një rreth në tjetrin dhe nga një fshat në fshatin tjetër. Në këtë kohë filluan punimet për ndërtimin e rrugës në distancë 22 kilometërsh që lidhte Pejën me Andrievicën, Podgoricën dhe Kotorrin. Kjo rrugë fillonte nga Peja për

në grykë të saj dhe mbaronte në Beluhë, në një gjatësi prej 22 kilometrash, e cila lidhte këto qytete: Beluha Velik, Andrievicë, Podgoricë dhe Kotorr. Në punimet për ndërtimin e saj detyrimisht merrte pjesë edhe popullsia e qarkut të Pejës.<sup>30</sup> Në këtë kohë, sipas statistikave të administratës austro-hungareze të fundvitit 1917, vetëm në qytetin e Pejës jetonin 12 000 frymë, shumica me përkatësi fetare islame, midis tyre afër 300 katolikë, pa theksuar elementin ortodoks.<sup>31</sup>

Në kushte të Luftës së Parë Botërore, e gjithë çfarë ofroi administrata ushtarake austro-hungareze për këto treva ishte zbatimi i një politike pjesërisht afirmative, emërimi i shqiptarëve në poste të administratës dhe emancipimi kulturor-arsimor i tyre, që synonte përmirësimin e statusit politiko-shoqëror, aftësimin dhe konsolidimin e shqiptarëve për një vetadministrim të ardhshëm nën Austro-Hungarinë. Në këtë kontekst, prefekt i qarkut të Pejës u emërua Nexhib Basha\*, një personalitet me përvojë administrative.<sup>32</sup> Prandaj, në vazhden e kujdesit dhe të përmirësimit të jetës politike, shoqërore e shëndetësore, në qytetin e Pejës u hap një spital civil me 50 shtretër (gusht 1916)<sup>33</sup> dhe një kuzhinë popullore (maj 1917).<sup>34</sup> Në raste festash, autoritetet austro-hungareze në Pejë e rrethinë ndanin të holla për familjet e varfra.<sup>35</sup> Një angazhim të veçantë kushtuar zbutjes së varfërisë midis popullsisë së Pejës e rrethinës, kishte dhënë komisari civil austro-hungarez, Emil Opalka. Ai bëri përshtypje pozitive tek popullsia e kësaj treve, për përkushtimin e tij ndaj

<sup>30</sup> *AIHT*, Vj. 27-4-436, nr. 25-B/P, Rezervat i Otto nga Cetina dërguar MPJ në Vjenë, Cetinë, 5 prill 1917; *Vëllazënija*, "Përparimi i popullit të Pejës", nr. 109, Vjenë, 4 Shtatuer 1918, f. 2; Sh. Rahimi, "E kaluara...", f.27.

<sup>31</sup> *Po aty*, Vj. 27-2-257, pa nr, Shkresë e guvernatorit të përgjithshëm ushtarak në Mal të Zi, kon tit Klam Martiniq, dërguar ministrin të Jashtëm kontit Czernin në Vjenë, Cetinë, 13 dhjetor 1917.

\* Nexhip Basha (1877-1952) ishte nga Peja. Në vitin 1904 diplomoi në Shkollën e Lartë Juridiko-Ekonomike në Stamboll. Ka ushtruar funksionin e kajmekamit në Pejë, Mitrovicë, Kumanovë, Preshevë, Vushtri e Veles. Si personalitet i njohur në veprimtari administrative, u emërua Prefekt i Vlorës në vitin 1914. Shih më gjerësisht: Muhamet Shatri, *Kryengritja e Përgjithshme Shqiptare kundërosmane e vitit 1912*, Prishtinë: "Libri Shkollor", 2016, f. 255.

<sup>32</sup> *Po aty*, Vj. 26-1-146, nr. 736, Telegram i Kral nga Shkodra për baronin Burian në Vjenë, pa datë.

<sup>33</sup> *Cetinjer Zeitung*, "Sanitäre Einrichtungen im Hü. G. 6. in Montenegro.", nr.2, Cetinje, am 20. August 1916, seite 3.

<sup>34</sup> *Po aty*, "Die Volksküche in Ipek.", nr.81, Cetinje, Donnerstag, den 24. Mai 1917, seite 3.

<sup>35</sup> *Po aty*, "Tagesneuigkeiten. Des Kaisers und Königs Geburtstag. Ipek.", nr.110, Cetinje, Sonntag, den 2. September 1917, seite 2.

familjeve të varfra, duke gëzuar respekt e popullaritet të madh. Vdekja e tij, më 22 qershor të vitit 1918, pikëlloi popullsinë e qarkut të Pejës.<sup>36</sup>

Veçori e administrimit të shtetit austro-hungarez në Pejë e viset përreth, ishte synimi për ruajtjen e karakteristikave kombëtare, kulturore dhe gjuhësore; të emrave të përveçëm të shqiptarëve, pavarësisht kuptimit apo domethënies së tyre. Autoritetet politike austro-hungareze në Vjenë morën masa për pastrimin e antroponimisë shqiptare nga elementët e serbizimit. Ato urdhëruan Cetinën zyrtare të frenonte praktikën e serbizimit të emrave e mbiemrave shqiptarë me prapashtesën “viq” në Pejë e rrethinë të saj. Sipas pikëpamjes së Vjenës zyrtare, përdorimi i mëtejshëm i prapashtesës “viq” në antroponiminë e shqiptarëve, lëndonte thellësisht ndjenjat kombëtare e kulturore të tyre.<sup>37</sup> Mirëpo, deri në tetor të vitit 1918, aq kohë sa këto treva qenë nën Austro-Hungarinë, organet administrative austro-hungareze me qendër në Cetinë, praktikisht nuk ndërmoren ndonjë veprim për pastrimin e antroponimisë shqiptare. Përkundrazi, prapashtesa “viq” vazhdonte të përdorej në mbiemrat e shqiptarëve.

Në përgjithësi, karakteristikë e pushtimit austro-hungarez në Ballkan, përfshi edhe Pejën e viset përreth, ishte zbatimi i një politike arsimore, që synonte zhvillimin e shpejtë të sistemit shkollor sipas modelit të kulturës perëndimore.<sup>38</sup> Një moment i veçantë që karakterizoi Pejën dhe rrethinën gjatë kësaj kohe ishte hapja e shkollave të para shqipe, të cilat u emërtuan me emrat e figurave të shquara kombëtare, si: Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe Haxhi Zeka. Në krye të institucioneve të larta të arsimit u emëruan personalitete të shquara, që njiheshin për vlera intelektuale, politike dhe kulturore-arsimore. Kontribut të theksuar në hapjen e shkollave dhe arsimimin e rinisë shqiptare dha veprimtari i shquar, historiani e profesori Bedri Pejani, i cili ushtroi funksionin e inspektorit të arsimit.<sup>39</sup> Duhet vlerësuar ndikimin e tij që një shkollë fillore në Pejë u emërtua “Skënderbeg”, ndërsa një tjetër “Haxhi Zeka”, që kishte paralelen

<sup>36</sup> *Po aty*, "Zivilkommissär Emil Opalka.", nr.198, Cetinje, Sonntag den 7. Juli 1918, seite 3.

<sup>37</sup> *AIHT*, Vj. 27-4-421, nr. 3222, Telegram i MPJ në Vjenë dërguar Storck, Vjenë, 15 qershor 1917; Beqir Meta, “Ndikimi i Luftës I Botërore në procesin e konsolidimit të kombit shqiptar”, *Studime shoqërore*, nr. 2-2015, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2015, f. 195.

<sup>38</sup> Helen A. Pavichevich, *Education and Modernization in Montenegro, 1831-1918*, Dissertations, USA: Layola University Chicago, 1976, f.7.

<sup>39</sup> *AIHT*, Vj. 27-4-421, nr. 3222, Telegram i MPJ në Vjenë dërguar Storck, Vjenë, 15 qershor 1917; B. Meta, “Ndikimi i Luftës I Botërore...”, f. 195.

e ndarë fizike në Kapeshnicë. Shkolla të tilla u hapën edhe në Gllogjan e Baran.<sup>40</sup> Krahas tij, Qerim Begolli dha ndihmesë materiale për funksionimin e shkollave shqipe. Ai, në gusht të vitit 1917, për qëllime shkollore në Pejë e rrethinë, dhuroi 1 000 korona.<sup>41</sup>

Midis mësimdhënësve më të spikatur, që u angazhuan maksimalisht për edukimin dhe arsimimin kombëtar të fëmijëve, rinisë e popullsisë shqiptare, ishin: Ali Hajdar Berisha, Xhevat Shkreli, Halit Kastrati, Zef Filip Krasniqi, Sylejman Shala, Kadri Harapi, Shaqir Çavolli, Muharrem Blakçori, Shaban Rexha, Murat Gjakova, Tomë Maroviqi (arbresh nga Zara) e të tjerë.<sup>42</sup> Në këto shkolla vijuan mësimet rreth 700 nxënës. Në fund të vitit 1917, për të përballuar nevojat didaktike të shkollave që po hapeshin dhe për kualifikimin e ngritjen pedagogjike të kuadrit profesional të mësimdhënies, që nuk kishte përvojë ose ishte i papërgatitur krahas standardeve moderne për arsimimin e nxënësve, organet austro-hungareze hapën një kurs pedagogjie në qytetin e Pejës, i cili u shërbeu mësuesve të qarkut të Pejës për t'u afirmuar në mësimdhënie dhe për të shërbyer si mësues nëpër shkolla. Këtë kurs, që zgjati 6 javë deri në 3 muaj, e ndoqën 40 mësues nga qarku i Pejës. Trajnues për përgatitjen e kuadrove mësimore në këtë kurs ishin: Bedri Pejani, Tomë Maroviqi, Zef Duka e trajnues të tjerë nga Berati, Elbasani e Shkodra. Qëllimi i këtij kursi ishte plotësimi i nevojave për kuadro të vendit, për hapjen dhe funksionimin e shkollave fillore në Pejë dhe vise të tjera të Kosovës.<sup>43</sup> Shkollat shqipe që u ndoqën nga fëmijët dhe të rriturit e këtij

<sup>40</sup> Demë Mulliqi, *Rrugëtimi i shkollës dhe arsimit në komunën e Pejës deri në vitin 1945*, Pejë: 2004, f. 54-55; Bajram Shatri, *Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX – sfida, dëshmi, fakte*, Prishtinë: “Libri shkollor”, 2006, f. 37; Abdulla R. Vokri, *Shkollat dhe arsimit në anën e Llapit brenda viteve 1878-1944*, Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, 1995, f. 45; Ali Lunji, *Beqir Kastrati legjendë e arsimit kosovar*, Prishtinë: “Libri Shkollor”, 2001, f. 13; Jashar Rexhepagiq, *Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918*, Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1970, f. 262; Sherif Daut Krasniqi, *Vranoci në përthyerje historike (etnomonografi)*, Pejë: “Dukagjini”, 2011, f. 479-480.

<sup>41</sup> *Cetinjer Zeitung*, "Tagesneuigkeiten. Des Kaisers und Königs Geburtstag. Ipek.", nr.110, Cetinje, Sonntag, den 2. September 1917, seite 2.

<sup>42</sup> *Monografia Peja: Vështrim monografik për Komunën e Pejës*, Pejë: Komuna e Pejës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, 2017, f. 281.

<sup>43</sup> *Vëllazënia*, “Kurs pedagogjie në Pejë”, nr. 85, Vjenë, 20 Dhetuer 1917, f.2; J. Rexhepagiq, *Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor...*, f. 262-263; Abdulla R. Vokri, *Ibrahim Kolçi mësues e patriot*, Prishtinë: “Rilindja”, 1993, f. 34.

qyteti, ndikuan në avancimin e identitetit kombëtar dhe në zhvillimet e mëvonshme politike të shqiptarëve.

Peja e viset përreth tërhoqën vëmendjen e shkencëtarëve austro-hungarezë, të cilët realizuan kërkime në fushën e zoologjisë dhe arkeologjisë. Nga muaji maj deri në shtator të vitit 1916, në Pejë, Rugovë, Plavë, Guci etj., qëndroi natyralisti austriak, dr. Arnold Penther, i cili në emër të Akademisë Imperiale të Shkencave në Vjenë, në këto treva realizoi ekspedita kërkimore-shkencore në fushën e zoologjisë.<sup>44</sup> Më 2 gusht ai i bëri një vizitë të përkohshme qytetit të Pejës, ndërsa nga 24 gushti deri më 2 shtator qëndroi në Pejë, ku arriti të siguronte informacione të rëndësishme për faunën e këtij qyteti dhe rrethinës. Po ashtu, rezultati i kërkimeve të tij në Pejë e rrethinë, i viseve tjera të Malit të Zi dhe të Serbisë, solli rreth 500 specie të lepidopterës.<sup>45</sup> Një vit më pas, në qershor e korrik 1917, arkeologu hungarez, dr. Budaj Arpad, realizoi kërkime arkeologjike në rrethin e Pejës, duke provuar gjurmë të lashtësisë së këtij areali.<sup>46</sup> Veç zbulimeve të tjera me karakter arkeologjik në këtë trevë, B. Arpad, më 17 qershor 1917, arriti në konstatimin se gërmadhat e lashtësisë së Pejës “... gjenden mbi një sipërfaqe të rrethuar mirë, në formë katërkëndëshi të çrregullt, me kulla të rrumbullakëta në qoshet... Gërmadhat janë në afërsi të drejtpërdrejtë të qytetit, në anën veriore të tij, midis rrugës që të çon drejt Mitrovicës dhe lumit të Bistricës në veri të saj”.<sup>47</sup> Rezultatet e studimeve të A. Penther dhe B. Arpad ngjallën interesim dhe u mirëpritën në qarqet shkencore austro-hungareze.

Veç kësaj, në Pejë e rrethinë u kremtuan edhe festat shtetërore austro-hungareze. Nga 6 deri më 14 maj 1918, nën atmosferën e një organizimi popullor, në Pejë nisi kremtimi i festës “Java e Karlit”.<sup>48</sup> Aty

<sup>44</sup> *Cetinjer Zeitung*, "Tagesneuigkeiten.", nr.11, Cetinje, am 21. September 1916, seite 3.

<sup>45</sup> *Lepidopteren aus Neumontenegro* (Ergebnisse der im Jahre 1916 im Auftrage und auf Kosten der Kaiserl. Akademie der Wissenschaften in Wien von Dr. Arnold Penther ausgeführten zoologischen Forschungsreise in Serbien und Neumontenegro), Von Prof. Hans Rebel, (Vorgelegt in der Sitzung am 11. Oktober 1917); Akademie d. Wissenschaften Wien, *Die lepidopterenfauna Albaniens* (mit berücksichtigung der nachbargebiete), von Hans Rebel und Hans Zenry, Vorgelegt ind der sitzung am 18. Juni 1931.

<sup>46</sup> *Monografia Peja...*, f. 54.

<sup>47</sup> Luan Përzhita, “Kontributi austro-hungarez për arkeologjinë shqiptare”, *Austro-Hungaria dhe Shqipëria, 1916-1918*, Tiranë: Ministria e Kulturës, Muzeu Historik Kombëtar, 2019, f. 234.

<sup>48</sup> *Posta e Shqypnis*, “Ndisija komtare e Pejës – Nji ftyrë e Skanderbegut 10.000 koronë” nr. 47, Shkodër, e Merrkure, 29 maj 1918, f.4; *Cetinjer Zeitung*, "Die Karlwoche in Ipek.", nr.195, Cetinje, Donnerstag den 27. Juni 1918, seite 4.

morën pjesë prijësit e shqiptarëve: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Qerim Begolli, Bedri Pejani etj. Veç tyre, morën pjesë edhe prijës fetarë e përfaqësues administrativë të qarkut të Pejës, si: kapiteni Sabo, komisioneri Civil Emil Opalka, kontabilisti Kirigin, gjyqtari civil Breqanoviq etj. Gjatë ceremonisë u prezantua në ankand një portret i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, për të cilin shqiptarët e Pejës ofruan 10 000 korona. Me propozim të Hasan Prishtinës, portreti iu dhurua komunës së Pejës.<sup>49</sup> Në këtë kuadër, autoritetet administrative austro-hungareze në Pejë çmonin rëndësinë dhe ndikimin që besimet fetare, prijësit fetarë dhe institucionet e objektet fetare kishin për popullsinë e kësaj treve. Në këtë kontekst, xhamitë dhe kishat e Pejës me rrethinë, veç funksionit të kryerjes së shërbesave e ritualeve fetare, u shfrytëzuan edhe për organizimin e shënimit të rasteve solemne shtetërore.<sup>50</sup> Prandaj, liria e shkollimit shqip në këto treva dhe afirmimi i figurave historike dhanë rezultate të mira për konsolidimin kombëtar të popullsisë shqiptare dhe për emancipimin kulturor-arsimor të saj. Kremtet shtetërore me përmbajtje folklorike, artistike dhe historike, krijonin një ndjesi të veçantë për popullsinë e Pejës dhe ngjallnin interesim të theksuar për njohjen e të kaluarës së shqiptarëve.

Një segment i veçantë i politikës së Austro-Hungarisë gjatë viteve 1916-1918, ishte ideja e bashkimit administrativ të qarkut të Pejës në kuadër të Qeverisë së Përgjithshme Ushtarake austro-hungareze në Shqipëri, me qendër në Shkodër. Kjo pikëpamje farkëtohej midis elitës politike e popullore shqiptare dhe në qarqet politiko-diplomatike austro-hungareze, por kundërshtohej me këmbëngulje nga qarqet drejtuese ushtarake dhe administrative austro-hungareze në Cetinë e Beograd. Bashkimi në një njësi të vetme administrative i viseve etnike shqiptare nën Austro-Hungarinë, nënkuptonte një akt politik të rëndësishëm për realizimin e aspiratave kombëtare të shqiptarëve. Mirëpo, ky synim nuk gjeti pëlqimin e drejtuesve administrativë austro-hungarezë në Cetinë. "*Pa rrethin e Pejës është e natyrshme se Mali i Zi nuk mund të ekzistojë ekonomikisht*", deklaronte guvernatori ushtarak i Malit të Zi, Klam Martiniq. Ai mendonte se politika shtetërore austro-hungareze duhej të fokusohet në realizimin e idesë për bashkimin politik dhe administrativ të sllavëve të jugut.<sup>51</sup> Duke parë që ideja e bashkimit etnik, politik dhe

<sup>49</sup> *Po aty*.

<sup>50</sup> *Cetinjer Zeitung*, "Tagesneuigkeiten. Dankgottesdienst für die Errettung unseres Kaisers und Königs.", nr. 132, Cetinje, Sonntag, den 18. November 1917, seite 2.

<sup>51</sup> *AIHT*, Vj. 27-2-257, pa nr, Shkresë e Guvernatorit të Përgjithshëm ushtarak në Mal të

administrativ të shqiptarëve nuk gjente përkrahje midis drejtuesve ushtarakë e administrativë të Austro-Hungarisë në Cetinë e Beograd, atëherë ministri i Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Ottokar Theobald Czernin, në dhjetor të vitit 1917, rikonfirmonte qëndrimin zyrtar të shtetit për të punuar më thellësisht në ringjalljen dhe forcimin e ndjenjave kombëtare e shtetërore shqiptare, që konsideroheshin si hapa thelbësorë për një vetadministrim të ardhshëm e zhvillim kulturor të shqiptarëve.<sup>52</sup> Ky qëndrim politikisht negativ reflektoi në ashpërsimin e pozicionit të shqiptarëve përballë Austro-Hungarisë dhe prezencës së trupave ushtarakë e administrativë në Pejë dhe qytete të tjera të Kosovës.

Rrjedhimisht, në verë të vitit 1918, vazhdimi i Luftës së Parë Botërore çonte Austro-Hungarinë me aleatë drejt kapitullimit, gjë që nxiti shqiptarët të vepronin sipas platformës së Komitetit “Mbroytja Kombëtare e Kosovës”. Në këtë situatë, prijësi i grupeve të armatosura shqiptare, Azem Galica, ra dakord me përfaqësues ushtarakë francezë në Shkup të niste sulmet për çlirimin e qyteteve të Kosovës, duke marr premtimin se më pas do të respektohej e drejta e shqiptarëve për vetëvendosje. Në këtë kuadër, në tetor 1918, përballja kryesore e armatosur u zhvillua për qytetin e Pejës, sepse forca të konsiderueshme austro-hungareze u bllokuan nga të gjitha drejtimet për tërheqje. Më 12 tetor, shqiptarët të udhëhequr nga Azem Galica, arritën të zinin forcat ushtarake austro-hungareze, të çarmatosnin ato dhe përfundimisht të çlironin Pejën. Pas pesë ditësh, me ftesë të Azem Galicës, trupat ushtarakë francezë arritën në Pejë.<sup>53</sup> Mirëpo, sipas kronikave franceze të frontit malazez të luftës, kavaleria franceze, e cila kishte mbështetjen e komitëve serbë, kishte sulmuar konvejerët austro-hungarezë që po tërhiqeshin nga Mitrovica, duke kapur 3 000 makina me sasi të madhe material. Ky detachment francez, të dielën e 13

---

Zi, kontit Klam Martiniq, dërguar ministrit të Jashtëm kontit Czernin në Vjenë, Cetinë, 13 dhjetor 1917.

<sup>52</sup> *Cetinjer Zeitung*, "Die Balkanvölker.", nr.137, Cetinje, Donnerstag, den 6. Dezember 1917, seite 2.

<sup>53</sup> *Arkivi Qendror i Shtetit i Republikës së Shqipërisë (AQSH)*, Fondi: Hoxhë Kadri Prishtina, nr. 422, dosje pa numër dhe vit, të cilës i mungojnë 9 fletat e para, fl. 15-16, 22, Dokument mbi gjendjen e popullsisë shqiptare të Kosovës në prag të përfundimit të Luftës së Parë Botërore, më 1918; Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica*, Botim i dytë, Tiranë: “8 Nëntori”, 1982, f. 58; Lush Culaj, *Shqipëria dhe problemi kombëtar 1918-1928*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2004, f. 28; Marenglen Verli, *Shqiptarët në optikën e diplomacisë austro-hungareze (1877-1918)*, Tiranë: “Klean”, 2014, f. 298.

tetorit 1918, “hyri në Pejë, ku kapi 600 të burgosur dhe dyqane enorme gruri”.<sup>54</sup>

Për pasojë, politika demagogjike franceze i lëshoi radhën dhunës. Me qëllim manipulimin e opinionit dhe faktorit relevant ndërkombëtar, përmes komunikatave zyrtare serbo-franceze, të publikuara në shtypin e huaj, u paraqitën informacione të rreme që kishin për fokus atributet e çlirimit të Pejës nga ushtritë e aleatëve serbo-francezë. Sipas tyre mohohej tërësisht prezenca dhe ndikimi i faktorit të armatosur shqiptar, që kishte luajtur rol vendimtar në çlirimin e Pejës.<sup>55</sup> Në këtë mënyrë, forcat ushtarake aleate serbo-franceze, me të ardhur në Pejë hoqën nga godina e komunës flamurin kombëtar shqiptar dhe portretin e Gjergj Kastriotit, morën situatën nën kontroll, riorganizuan administratën dhe rivendosën regjimin serb. Shqiptarët e kuptuan se përfaqësuesit ushtarakë francezë kishin ndjekur një politikë mashtrimi karshi aspiratave të tyre, prandaj protestuan tek qeveria franceze.<sup>56</sup> Ditët dhe muajt në vijim, regjimi ushtarak serb filloi dhunshëm çarmatosjen e popullsisë, që domosdo nxiti revoltën e shqiptarëve e për pasojë akte dhune, vrasje e masakra ndaj tyre.<sup>57</sup> Kësisoj, filloi edhe rrënimi i të arriturave ekonomike, shoqërore dhe kulturore-arsimore të shqiptarëve të këtij qyteti dhe rrethinës, që kishin ndërtuar me vështirësi përgjatë një periudhe pothuajse tre-vjeçare.

<sup>54</sup> *Pages de Guerre, Ecrites au jour le jour, Fascicule deux cent-treizième, Ein pleine Guerre*, "Communique de l'armée d'Orient", 17 octobre 1918, Nancy (5 Novembre 1918), f.6812, 6823; *The Kia Ora Co-ee news*, "In Macedonia", Official Magazine of the Australian and New Zealand forces in Egypt, Palestine, Salonica & Mesopotamia, No.10, October 23rd., 1918, page 7.

<sup>55</sup> *Le figaro*, "ARMEE D'ORIENT", nr. 291, Paris, vendredi, 18 octobre 1918, f. 1.

<sup>56</sup> *AQSH*, Fondi: Hoxhë Kadri Prishtina, nr. 422, dosje pa numër dhe vit, të cilës i mungojnë 9 fletat e para, fl. 15-16, 22, Dokument mbi gjendjen e popullsisë shqiptare të Kosovës në prag të përfundimit të Luftës së Parë Botërore, më 1918; L. Culaj, *Shqipëria dhe problemi kombëtar...*, f. 28.

<sup>57</sup> *Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK)*, Fondi: Koleksioni – lënda memoare, kutia nr.2, Kujtime të Gjoke Pantiq, f.22; B. Hrabak, "Reokupacija oblasti Srbske i Srnagorske...", f.256-258; Димитар Тасић, *Рат после рата - Воска Краљевине Срба, Хрвата и Словенаца на Косову и Метохији и у Македонији 1918-1920*, Београд: "Институт за Стратегијска Инстраживања", 2008, f.46-37; Hakif Bajrami, "Si e rikupoi Serbia Kosovën më 1918", në *Vjetar*, nr.XXXVII-XXXVIII, Prishtinë: Arkivi i Kosovës, 2007, f.213-221; Izber Hoti, "Peja me rrethinë në fund të vitit 1918 mbështetur në të dhënat serbe", në *Kosova*, nr.28-2006, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2006, f.200.

Fitim RIFATI

SUMMARY

### **THE CHARACTERISTICS OF AUSTRO-HUNGARIAN CONQUEST AND ADMINISTRATION IN PEJA (1915-1918)**

Peja and the surrounding areas during the First World War went through an important historical process, which affected all areas of political, military, social, economic and cultural-educational life. While the Montenegrin government aspired to accomplish its policy of national and cultural transformation of these territories, always minimizing their Albanian character and presence, under Austria-Hungary these territories experienced an affirmative policy, which aimed at reviving the national feelings of Albanians and consolidating their state, to take over the fate of the future.

The rights to use the Albanian language, to guide administrative positions, to open schools in the Albanian language, to commemorate the national and religious celebrations, to use national symbols and affirm historical figures, were positive elements that the Albanians of Peja and the surrounding area enjoyed under Austro-Hungarian occupation and administration. In addition, the general circumstances of the First World War, prompted the Austro-Hungarian military administration to punish any Albanian who didn't accept administrative authority. The liberation of Peja by the Albanians on the one side and its reconquest by the Serbo-French allies in October 1918, restored the Serbian policy towards the Albanian people of this region and consequently the continuation of the Albanian armed efforts for liberation and national unification.